

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "SHËRBIM HOTELERI AKOMODIM PËR PERSONELIN"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 55110000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 67,208,667.67 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, ose 699,070.81 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.14), datë 12.03.2025)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 76, 82, 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë (të vlefshme) Kategorizimi për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, Kategoria: Hotel, lëshuar nga organi shtetëror kompetent.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në ligjin Nr. 93/2015 "Për

turizmin”, i ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 213, datë 19.11.2025 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret, afatet, si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese”, me qëllim garantimin e AK se ofertuesi e ushtron veprimtarinë e tij si strukturë akomoduese në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet rregullore përkatëse.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 OE duhet të dëshmojë se Vendndodhja e hotelit të jetë jo më larg se 30 km me rrugë automobilistike nga Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë/qiramarrjen/ huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje noteriale/ kontrata huapërdorje noteriale/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohet vendodhja dhe largësia nga SRMF.
- akt miratimi higjeno – sanitar (të vlefshëm) për strukturën akomoduese, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë strukturën akomoduese për realizimin e shërbimit të akomodimit të personelit turk.

Vendndodhja e hotelit është kërkuar nga AK SRMF, të jetë jo më larg se 30 km me rrugë automobilistike nga Spitali Rajonal “Memorial” Fier, për arsyt:

Kjo distancë parashikohet me qëllim ofrimin në kohë të shërbimit mjekësor nga ana e stafit mjekësor, duke qënë se mjekët turq duhet të paraqiten brenda orarit zyrtar në punë si dhe sa më shpejt të jetë e mundur në raste urgjente. Në bazë të Protokollit të mësipërm Spitali Memorial Fier, mbulon shërbimin e transportit të stafit turk nga hoteli në spital për cdo ditë për tu paraqitur në punë. Gjithashtu, Hoteli ku do të akomodohet stafi turk duhet të jetë në një distancë të arsyeshme nga godina e Spitalit për shkak edhe të urgjencave të paparashikuara të thirrjeve të mjekëve në punë, gjatë 24-orarshit, pa orar të caktuar etj. Kjo distancë automobilistike siguron që mjekët të paraqiten në spital brenda minutash si dhe siguron akses të shpejtë në shërbimet shëndetësore dhe është i përshtatshëm për infrastrukturën rrugore të Shqipërisë, duke garantuar një shërbim efektiv dhe ekonomik për spitalin dhe pacientët.

Reagimi i shpejtë i personelit mjekësor për rastet urgjente është kyç për të parandaluar përhapjen e komplikacioneve dhe për të ulur shkallën e ndërlikimeve në rastet urgjente. Mjekët duhet të arrijnë në spital brenda minutash për të ofruar shërbime të shpejta dhe të efektshme, duke siguruar që pacientët të trajtohen menjëherë dhe të përfitojnë nga trajtimi optimal, duke parandaluar komplikime të mundshme. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është që reagimi i shpejtë i mjekëve jo vetëm që shpëton jetë, por gjithashtu ndihmon në uljen e shpenzimeve të përgjithshme të spitalit (shpenzime spitalore dhe shpenzime të karburantit). Kostoja për trajtimin e pacientëve që vonohen për një periudhë të gjatë është shumë më e lartë, pasi ndodhin shpesh komplikacione dhe nevojiten trajtime shtesë. Kjo ndikon negativisht në cilësinë e shërbimit dhe e bën trajtimin më të kushtueshëm për spitalin, si dhe për pacientët.

Pajisja me aktin higjeno-sanitar e strukturës akomoduese është vendosur bazuar në ligjin Nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 213, datë 19.11.2025 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret, afatet, si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese”, në Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 139, datë 14.4.2011, “Për lëshimin e akt miratimit higjeno-sanitar”, Udhëzimin nr.510, datë 13.12.2011, “Për inspektimet higjeno-sanitare në funksion të lëshimit të akt miratimit higjeno-sanitar”, me qëllim garantimin e sigurisë dhe kushteve higjeno-sanitare për personelin që do të akomodohet.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të shërbimeve që merr përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. Nisur nga natyra e objektit të prokurimit, i cili përfshin shërbime të integruara, ku përveç fjetjes, përfshihen edhe shërbime të tjera të lidhura si ofrimi i mëngjesit, ndërrimi periodik i carcafëve, pastrimi i dhomës, mirëmbajtja e ambienteve të akomodimit, etj., pajisja e operatorit ekonomik me këtë standart është një garanci shtesë që ofertuesi disponon një sistem të dokumentuar dhe të certifikuar për menaxhimin dhe kontrollin e proceseve të shërbimit,

duke siguruar ofrimin e shërbimit në mënyrë të organizuar dhe në përputhje me standarte të qëndrueshme të cilësisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër realizimin e shërbimit objekt prokurimi, sipas të gjitha kushteve të kërkuara në specifikime teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Paraqitja e deklaratës së kërkuar krijon përgjegjësi kontraktuale për realizimin e shërbimit, si dhe siguron AK se ofertuesi pranon dhe garanton përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Spitali Rajonal Memorial Fier”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës të argumentuara sipas nevojave të Autoritetit përfitues, janë pjesë e DST.

Në dokumentacion e përcjellë nga AK “SRMF”, për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit, rezulton se :

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare” neni 4 pika 3 e tij, një prej detyrimeve të palës shqiptare është:

3. “Të mbulojë shpenzimet e brendshme të pagave, akomodimit dhe transportit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga pala turke...”.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, në shërbimet e akomodimit të personelit turk përfshihen kërkesat e përcaktuara në formularin e specifikimeve teknike.

Gjithashtu AK “SRMF”, sqaron se:

Në kuadër të Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal Memorial Fier gjatë fazës kalimtare, miratuar me VKM nr. 58, datë 26.01.2022, është parashikuar një regjim i posaçëm bashkëpunimi ndërqeveritar, i cili ka natyrë publike dhe institucionalo-shtetërore. Ky bashkëpunim nuk përbën një marrëdhënie të zakonshme tregtare, por një marrëveshje ndërkombëtare që përfshin

praninë dhe ushtrimin e funksioneve profesionale nga stafi mjekësor turk në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të një projekti strategjik shëndetësor, siç është Spitali Rajonal "Memorial" Fier.

Duke qenë se stafi turk ndodhet në Shqipëri në zbatim të një marrëveshjeje ndërqeveritare ndërmjet Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, ambientet ku ky staf akomodohet marrin një status funksional të lidhur drejtpërdrejt me realizimin e kësaj marrëveshjeje. Për rrjedhojë, këto ambiente nuk mund të trajtohen si hapësira të zakonshme të aktivitetit të lirë tregtar, por si ambiente që kërkojnë masa të posaçme sigurie, kontrolli dhe administrimi. Vlen të theksohet se ky është spitali i parë publik në shtetin shqiptar që funksionon dhe janë të punësuar tashmë që prej muajit maj 2021 e aktualisht, punonëjs turq mjekësor dhe administrativ. Kjo është dhe një kërkesë e shprehur nga vet pala turke. Lejimi i personave të tretë brenda ambienteve ku akomodohet stafi turk do të cenonte drejtpërdrejt standardet e sigurisë. Prania e individëve të paautorizuar rrit rrezikun e incidenteve, të ndërhyrjeve të padëshiruara apo të situatave që mund të krijojnë paqartësi në përcaktimin e përgjegjësisë. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për personel të angazhuar në një mision shtetëror dhe në një institucion publik, çdo cenim i sigurisë do të kishte pasoja jo vetëm kontraktore, por edhe institucionale dhe potencialisht diplomatike.

Lëshimi i faturave tatimore për shërbime ndaj të tretëve, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës për akomodimin e stafit turk në kuadër të funksionimit të Spitali Rajonal Memorial Fier, duhet të konsiderohet jo vetëm si çështje financiare, por si element verifikues i respektimit të kushteve të sigurisë. Më konkretisht, moslëshimi i faturave tatimore ndaj personave të tretë gjatë kësaj periudhe shërben si mekanizëm objektiv kontrolli dhe prove dokumentare se operatori ekonomik nuk ka ushtruar aktivitet tregtar me klientë të jashtëm dhe, për rrjedhojë, nuk ka lejuar akses të personave të paautorizuar në strukturën akomoduese.

Në këto kushte, kërkesa që operatori ekonomik të mbyllë aktivitetin tregtar brenda rrethimit, të mos lejojë klientë të tretë dhe të mos lëshojë fatura për shërbime ndaj tyre gjatë periudhës së kontratës, përbën një masë të arsyeshme, proporcionale dhe të justifikuar. Kjo masë synon garantimin e sigurisë, mbrojtjen e privatësisë së stafit turk, ruajtjen e integritetit të marrëveshjes ndërqeveritare dhe shmangien e çdo paqartësie administrative apo institucionale, në përputhje me frymën dhe qëllimin e VKM nr. 58, datë 26.01.2022.

NJËSIA E PROKURIMIT